

ANTHROPONYMS IN SOCIAL LIGHT

Valdet HYSENAJ¹

¹Universiteti "Fehmi Agani" i Gjakovës Fakulteti i Edukimit
e-mail: valdet.hysenaj@uni-gjk.org

Abstract

The attempt to illuminate personal names from a socioonomastic point of view undoubtedly marks the first attempt of this nature in the field of research and inquiry, because until now the social aspect of anthroponymy has not had any object of study or treatment of this issue. Through naming in socio-onomastic terms it is required to investigate and find out what is really in a name, the reasons why it is such in certain social circumstances and conditions, purpose, causes, advantages, etc., at the same time investigate cultural knowledge, etymology, history, and why not the linguistic characteristics announced in the names, as well as explaining the meaning of names in all forms and socioonomastic and theoretical discussions of views and concepts.

Their content is diverse as: anthroponyms of Catholic and Muslim faiths, anthroponyms according to physical properties, animal world, plant world, anthroponyms according to the configuration, different anthroponyms, hypocoristics, names of tribes, brothers, herbs and houses, etc.

For well-known reasons, most of the personal names in our country are dominated by names of foreign origin: Greek, Roman, Slavic, Oriental (Arabic - Turkish - Persian), Hebrew, Italian, French, German, German, Spanish, Russian and most recently (with an unprecedented momentum and with an extremely dangerous denationalizing force) even Anglo-American.

Keywords: *Muslim anthroponyms, social light, socioonomastics, naming, personal names.*

1. Antroponimet në dritën sociale

Përpjekja për të ndriçuar emrat vetjakë nga këndvështrimi socioonomastik pa dyshim shënon përpjekjen e parë të kësaj natyre në fushën e gjurmimit dhe të hulumtimit, sepse deri më sot aspekti social i antroponimisë nuk ka pasur ndonjë objekt studimi a trajtimi të kësaj çështjeje.

Përmes emërvënies në aspektin socioonomastik kërkohet që të hetohet dhe të gjendet se çfarë është me të vërtetë një emër, arsyet se pse është i tillë në rrethana dhe kushte të caktuara shoqërore, qëllimi, shkaqet, përparësitë etj., njëkohësisht hetohen njohuritë kulturore, etimologjia, historia, pse jo edhe karakteristikat gjuhësore të shpallur në emra, si dhe shpjegim-kuptimi i emrave në të gjitha format dhe diskutimet socioonomastike dhe teorike për pikëpamjet dhe konceptet. Përmbajtja e tyre është e larmishme si: antroponime konfeksionesh të besimit katolik dhe mysliman, antroponime sipas vetive fizike, botës shtazore, botës bimore, antroponime sipas konfiguracionit, antroponime të ndryshme, hipokoristika, emra fisesh, vëllezërish, barqesh dhe shtëpish etj.

Për arsye të njohura të shumica e emrave vetjakë të ne mbizotërojnë emrat me prejardhje të huaja: greke, romake, sllave, orientale (arabe – turke – persiane), hebraike, italiane, franceze, gjermane, spanjolle, ruse e tashti së fundi (me një vrull të paparë e me një forcë shkombëtarizuese tejet të rrezikshme) edhe anglo-amerikane.

Leksemat themeltare: *antroponime myslimane, dritë sociale, socioonomastikë, emërvënie, emra vetjakë.*

2. Antroponimet në dritën sociale (antroponimet e konfeksionit mysliman)

Ndikimi i turqve gjatë sundimit të tyre shumëshekullor në trojet tona qe shumëdimensional në të gjitha fushat dhe poret e jetës. Populli shqiptar gjatë këtij sundimi përjetoi të dëbohej me forcë, me ndarje, me shpërngulje, me denatyrin, duke provuar të gjitha mënyrat e errësimit, zvogëlimit dhe uljes së qëllimshme të vlerave ekzistuese, përmes përgojimeve, nënçmimit, përluljes e keqtrajtimit si asnjë popull tjetër në Ballkan, e që e gjithë kjo ende nuk është shpjeguar nga historiografia shqiptare.

Dominimi shumëshekullor turk tek popujt e Ballkanit në përgjithësi, ndërsa tek populli shqiptar në veçanti, ravijëzoi ndikime të mëdha në fusha të ndryshme të veprimtarisë, me theks të veçantë islamizmin, fenë e re, që u shtri edhe në fushën e antroponimisë duke vënë në përdorim një numër të madh emrash vetjakë myslimanë të gurrës orientale që edhe sot janë të shpeshtë në Pejë (vendhulumtimi ynë) me rrethinë. Ashtu si edhe në fusha të tjera, mungesa e të dhënave shkrimore të duhura për kohën, akoma mbetet e hapur. Me këtë rast ne do të pikëzojmë ca shkëndijëza në këtë drejtim. Kësaj çështjeje mund t'i përgjigjet vetëm ndonjë supozim analog me anë të tjera të Kosovës apo edhe më gjerë. Në këtë plan, duke e ndriçuar çështjen e përkatësisë etnike dhe fetare të popullatës së Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI prof. M. Tërnavë, ndër të tjera, shkruan: "... popullsia e besimit islam të Prishtinës brenda jo plot një shekulli, nga viti 1487 kur numëronte 51 shtëpi, në këtë kohë, midis viteve 1566 – 1574, kishte arritur t'i ketë 309 shtëpi (Tërnavë, M. (1979) *Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI*).¹" Kështu, brenda kësaj periode dhe më vonë, sipas pohimeve të historianëve bie në sy rënia e dukshme e numrit të popullsisë së krishterë dhe rritja e vazhdueshme e popullsisë me përkatësi fetare islame që, njëkohësisht, është rezultat i zhvillimit të procesit të islamizmit dhe i pranimit të tij nga popullata e krishterë. Ndërkaq, prof. M. Krasniqi vë re se më 1591 më se 420 familje shqiptare të Podrimës kishin antroponimi të përzier katolike e myslimane që dëshmon se "procesit i islamizmit të shqiptarëve në këtë kohë kishte marrë përmasa të mëdha". (Krasniqi, M. (1979) *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike*).²

Edhe pse "Në trevat malore, ku osmanët nuk ushtronin një autoritet të fortë, popullsia i bëri ballë me lehtësi trysnisë islamizuese dhe e ruajti fenë e mëparshme", (Shpuza, G. (1995) *Islamizimi ndër shqiptarët*)³ potencojmë se treva e Rugovës së Pejës ishte madje kalaja e fundit e islamizimit. Këtë të dhënë e hasim dendur edhe në krijimet nga letërsia popullore edhe nga të dhënat e të parëve, gjë që vërehet edhe nga etnogjenezat familjare rugovase.

3. Qasje socioonomastike antroponimike

Do të ishte me interes socioonomastik të veçonim rastin në Shkrel (Shqipëri), pikërisht në pjesët fushore e më pak të mbrojtura ku shkeli turku do të bigëzohej edhe besimi: njëra lagje mbeti katolike dhe mban mbiemrin Ndreaj, kurse tjetra u kthye në besimin mysliman dhe u quajt Isufaj. (Shkurtaç, Gj. (2001) *Onomastikë dhe etnolinguistikë*)⁴, andaj me të drejtë kjo problematikë quhet bigëzim socioonomastik shqiptar, sepse faktori shoqëror në këtë rast është parësor për zhvillim ngjarjesh sipas kësaj kronologjie. Bazuar në të dhënat e përgjithshme si dhe deri diku në bazë të

emrave të breznive vendëse që i shënuam në terren p.sh. *Arbnori*, *Arbnor Agroni*, *Agroni*, *Agron Mehmeti*, *Mehmeti*, *Mehmet Sadiku*, *Sadiku*, *Sadik Bajrami*, *Bajrami*, *Bajram Nimani*, *Nimani*, *Niman Hyseni*, *Hyseni*, *Hysen Aliu*, *Aliu*, *Ali Gera* dhe raste të tjera të ngjashme supozojmë se në gjysmën e dytë të shekullit XVII duhet kërkuar me saktësi koha e islamizmit të popullatës kur edhe u përhapën antroponimet fetare myslimane në këto anë. Sido që të jetë, duke qenë zonë malore dhe anësore, islamizmi në këtë anë nuk ka mundur të depërtojë shpejt dhe krahas me anë të tjera. (*Mujaj H. (1983) Koha 4*)⁵ As për mënyrën e pranimit të islamizmit të banorëve të këtyre anëve nuk ka të dhëna bindëse. Të moshuarit këtë e shpjegojnë se kinse feja islame u është dukur më e mirë

Neve na duket se edhe kjo çështje do parë në mënyrë analoge me treva të tjera; në fillim kanë kaluar në fenë islame vetëm meshkujt me qëllim që të shpëtojnë ose, së paku, të lehtësohen nga pagimet dhe tatimet e ndryshme e pastaj ky proces është bërë i përgjithshëm. Në anën tjetër, duke qenë përherë në përballje të ashpra me pushtuesit, duke qenë prore në papajtueshmëri me sistemin, klasën sunduese, grupin shoqëror imponues, duke pësuar në vijimësi veprimtari goditëse të organizuara dhe të zhvilluara nga sistemi shoqëror, duke qenë në shënjestër të mposhtjes dhe asgjësimit, mund të themi se banorët, si vetëqeverisës, domosdoshmërisht pranuan regjistrimin e përgjithshëm të tokave, më 1506 dhe sipas dispozitave themeltare të regjimit feudalo – ushtarak dhe të marrëdhënieve shoqërore – ekonomike, po ashtu pranuan që pushtetit osman t’i jepnin një taksë (haraç) fikse, dhe ndryshe nga timaret, që aplikohesh në të 32 vilajetet e Perandorisë Osmane në trojet shqiptare, si edhe në zonat e tjera quhej zonë haraçi. Zaten, kjo edhe nuk nënkuptonte nënshtrim, por bindje për palën kundërshtarë se veprimtaria e këtyre anëve dhe gjithçka tjetër i shërbente asaj, prandaj këtë me të drejtë edhe mund ta quajmë luftë politike, ideologjike, ekonomike dhe diplomatike. Duke bërë fjalë rreth çështjes së islamizmit A. Hanezhiq konstaton: “Problemi i islamizmit në historiografinë tonë ende nuk është fare i ndiçuar” (*Hanezhiq, A. (1970) O islamizaciji u sjeveroistočnoj Bosni*)⁶. Po ky autor vë në spikamë se rreth këtij problemi të rëndësishëm, sidomos rreth fillimit të këtij procesi dhe intensitetit të tij, ka pikëpamje të ndryshme. Ndërkaq I. Smailoviq, përkritazi me këtë çështje shton: “Problemi i islamizmit të banorëve tanë edhe më tutje kërkon analizën dhe sintezën e vet shkencore pa të cilat nuk mund të jepen mendime të sigurta. Kjo punë u përket gjithsesi historianëve” *Smailoviq, I. (1977) MIOPBH*)⁷. Sidoqoftë, me pranimin e fesë së re islame, është dashur që të pranohet edhe emri vetjak “si shënim formal i përkatësisë së religjionit të ri” (*Po ay*)⁸. Pra, emrat myslimanë të gurrës orientale (me origjinë arabe, turke, persiane) kanë hyrë tek ne si pasojë e islamizimit të popullatës. Sa për studimin e emrave myslimanë, mund të thuhet se krahas ndonjë vështrimi të mëparshëm, më thellë dhe më gjerë gjurmohen në veprën leksikografike të A. Shkaliqit me titull: “Turqizmat në gjuhën serbokroate”, sipas veprës së I. Smailoviqit në të cilën, në mes të 8742 fjalëve, gjenden edhe 875 emra vetjakë myslimanë. Këtyrë antroponimeve autori u qaset nga këndvështrime të ndryshme si: aspekti burimor, kuptimor, prekja e çështjes së theksit të tyre etj. Një kontribut të madh në fushën e kërkimit të emrave vetjakë myslimanë jep prof. I. Smajlovic i cili i mbledhi dhe i analizoi gjithanshëm 3073 antroponime myslimane të gurrës orientale të të dyja gjinive në territorin e Bosnjës dhe të Hercegovinës, duke përfshirë këtu edhe hipokoristikat.

Antroponimet mysimane në anën e hulumtimit tonë kishin shtrirje më të tepërt në të kaluarën, por që sot nuk kanë shtrirje të gjerë. Nga antroponimet e këtilla, ashtu sikundër edhe nga antroponimet e tjera shkojnë edhe formohen edhe patronime që, siç dihet, kanë jetë më të gjatë se antroponimet. Emrat e marrë nga sfera fetare shpeshherë shkojnë dhe lidhen me emrin e ndonjë feste të besimit të popullatës; në rastin tonë është i shpeshtë për shembull emri Bajram i burimit oriental (nga tur. dhe pers. “ bayram ” - festë, argëtim). Në FGJSSH (FGJSSH. (1982) Rilindja. Prishtinë)⁹ ka këtë sqarim: Bajram m. fet. Emër i dy festave fetare kryesore të myslimanëve, që festohen pas ramazanit (në vendet ku vepron feja myslimane). Bajrami i madh (i vogël),

4. Trajtimi socioonomastik i emrave Bajram dhe Muhamet

Pikërisht, antroponimi i dalë nga kjo festë, i përdorur mjaft dendur në këtë trevë, në rrjedhë kohe, në aspektin socioonomastik përshkohet në rend të parë po nga aspektet shoqërore, dëshirën e prindërve që edhe emri i fëmijës së tyre të shërbejë për fisnikërimin e shpirtit dhe rritjen e besimit në vlerat më sublimë të njeriut, këtu është shprehur qëllimi i vërtetë social i cili duhet të jetë shembull dhe mësim i sakrificës për të tjerët. Morali islam këtë sakrificë e konsideron një nga virtytet më të larta të njeriut dhe si nevojë morale të shoqërisë. Prej kësaj rrjedh parimi i njohur i moralit islam: “Njeriu më i mirë është ai prej të cilit kanë dobi njerëzit, kurse më i keqi është ai cili u bën dëm atyre” (Skalic, A. (1965) *Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku*)¹⁰.

Ky emër rëndom u jepet fëmijëve që pagëzohen në këtë festë fetare myslimane ose edhe në prag të saj. Duke shkruar për këtë antroponim I. Smailoviq thotë: “ Kësi emri zakonisht i jepet fëmijës që lind ditën e parë të kësaj feste.”

Duke bërë fjalë rreth emrave fetarë prof. M.Krasniqi, ndër të tjera, thekson: “Në lidhje me emrat nga sfera bie në sy që prindërit në këto raste dëshirojnë që fëmija i tyre të pagëzohet me emrin e ndonjë shejti të njohur”¹¹ (Krasniqi, M. (1979) *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike*).

Vështruar nga ky kënd, këndeje përdoret emri Muhamet nga tur. dhe ar. që do të thotë shumë i lavdëruar, i festuar (*Elezoviqit, G. (1932) RKMD*)¹². Emri Muhamet është shumë i shpeshtë tek të gjithë popujt e islamizmit, sepse kështu është quajtur themeluesi i tyre.

Sipas një gazetaresje spanjolle ky emër është më i përhapuri në botë, ajo pohon se afro 150 milionë njerëz në botë e bartin këtë emër, madje është mbizotërues si në Indi, Pakistan, Bangladesh etj., po ashtu, ajo bën me dije se ky emër është i përhapur edhe në vende të tjera me ndryshime leksikore, hipokoristike, shënimi ynë, p. sh.:

- Në Turqi: *Mehmet*;
- në vendet e Azisë: *Mohamed*;
- në vendet e shkretëtirës afrikane: *Mamadou*;
- në Bosnjë: *Meho*;
- në disa provinca të Francës: *Meho*.

Për nga përhapja është i gjashti në mbretërinë e Britanisë së Madhe, po ashtu ky emër ka shtrirje të konsiderueshme tek myslimanët në Spanjë.

Përdorim të dendur ka nga refugjatët myslimanë në vende të ndryshme të botës. Aspektet fetare ndërlidhen me jetën familjare dhe shoqërore, ky emër lidhet edhe me ritualet përmes besimit deri te veprimtaria shoqërore dhe ndihmesa sociopsikologjike në të gjitha aspektet: individuale, shoqërore, ekonomike, politike dhe shpirtërore.

Sigurisht se ky antroponim jep një kontribut jo të vogël për qëndrueshmërinë sociale dhe si i tillë ka një rol social, gjithashtu edhe për rregullat të cilat duhet të zbatohen duke u bazuar në aspektet shoqërore. Në një farë mënyre, kjo emërvënie vë rregulla humane në jetën sociale, është një emër ritual tek i cili aspektet shpirtërore duhet të reflektojnë më shumë sesa ato fizike, familjare etj. dhe t'i përkushtohet vetëm çështjes shoqërore, besimore, ndjenjësore, psikologjike, sociale, etj.

5. Shpjegimi antroponimik i emrave myslimanë orientale

Në vazhdim po i paraqesim disa emra myslimanë orientale që janë përdorur më herët apo që përdoren edhe sot në Pejë me rrethinë, duke e sqaruar burimin dhe domethënien e tyre në gjuhën tonë. Avdyl, mendojmë se është hipokoristik nga emri Avdullah, i cili rrjedh nga ar. “abe” - rob, shërbëtor dhe “allah” - Zot; se Avdyl është shkurtim nga Avdulla e dëshmon edhe mendimi i G. Elezoviqit¹⁴: “Avdyl – pa dyshim është hipokoristik nga emri Avdullah, Adem (prej ar. Adam – lloj njeriu), Agan (nga tur. Aga – zotëri, udhëheqës), Ahmet (nga ar. Ahmad – i lavdëruar), Ajshe (ar. e gjallë, ekzistuese), Ajete (nga emri mashkullor Ajet me formantin – e), Ali (ar. i gjatë), Beqir (tur. Bekir – fëmija i parë i lindur); etimologjinë e këtij antroponimi I. Smailoviq e paraqet të diskutueshme, Beqë, hipokoristik nga Beqir, Bedri (ar. Hënë e plotë), Bedri, me ndërrimin e vendit të theksit, nga emri mashkullor është bërë emër i gjinisë femërore, Begie (tur. Beg), Brahim, Ibrahim, Braho (hipokoristik nga Ibrahim), Bektesh (pers. i rritur, i njëjtë), Bekë (shkurtim nga Bektesh), Behare (pers. pranverë), Qerim (modifikim nga Kerim), Deli (tur. i fortë), Dervish (pers. i varfër), Xhemajl (ar. bukuri), Xhemë (hipokoristik nga Xhemajl), Xhevahire (tur. gur i çmuar), Xhevdet (tur. shq. kualitet i lartë), Gjylë (pers. shq. lule), Emin (tur. shq. i ndershëm), Emine (nga Emin me formantin - e), Enver (tur. shq. shumë i ndritur), Fadil (tur. shq. i jashtëzakonshëm, i shkëlqyeshëm), Fahrie (tur. shq. e mburrur, autoritative), Fatime (në përkthim nga ar. dmth. “e larguar nga gjinjtë”), Fazli (tur., shq. i mirë, i merituar), Gani (ar. shq. i pasur), Haxhi (në Pejë, siç thuhet në terren rëndom i jepet fëmijës që pagëzohet në festën myslimane Haxhi – Bajram); emri Haxhi zakonisht për festën fetare të Haxhi – Bajramit u dhënka edhe tek popullata myslimane e Bosnjë dhe Hercegovinës. Hajdar (tur. shq. luan), Hajrie (tur. shq. Fatlume), Haki (ar. shq. i drejtë, i vërtetë), Halil (ar. shq. mik i besueshëm), Halime (ar. shq. e butë, e kujdesshme), Hasan (tur. shq. i bukur), Hazir (ar. shq. i kujdesshëm, i përgatitur), Hysnie (ar. shq. e bukur), Ibrahim (ar. shq. baba i popullit), Ibër (hipokoristik nga Ibrahim), Idriz (burimi i paqartë), Islam (ar. shq. thirrje e religjionit mysliman), Ismet (tur. shq. ruajtje, mbrojtje), Jah (hipokoristik nga Jahja); emër me burim të diskutuar; Jashar (tur. shq. ai jeton), Kadri (ar. shq. ai që është i lidhur për fatin dhe dëshirën e Zotit), Kapllan (tur. shq. tigër, leopard), Kumrie (ar. shq. zog), Kurt (tur. shq. Ujk), Mehmet (tur. shq. i festuar), Muharrem (ar. shq. i ruajtur, i ndaluar), Musafë (tur. shq. i zgjedhur), Naim (tur. shq. i butë), Nezir (ar. shq. ai që tërheq vërejtjen të

shkohet rrugës së drejtë), Nuria (ar. shq. dritë), Osman (ar. shq. “zog i ri” ose “gjarpër i ri”; se si u bë emër i përveçëm është vështirë të thuhet, por është e besueshme sipas I. Smailoviqit, të jetë emër mbrojtës¹³; Osman është quajtur edhe themeluesi i shtetit të pavarur turk sipas të cilit edhe është quajtur p.sh. sundimi osman; Pakize (pers. shq. e pastër), Rabë (hipokoristik nga Rabie), Ramadan (ar. emri i muajit të nëntë të islamit), Ramë (hipoko. nga Ramadan), Ramiz (ar. ai që tërheq vërejtjen në diçka, që shprehet figurativisht), Rexhep (emri i muajit të shtatë të numërimit fetar mysliman i muajve), Rexhë (hipoko. nga Rexhep), Rizë (ar. shq. kënaqësi), Rrustem (pers. shq. i fuqishëm, i shq. i sinqertë), Sadie (ar. shq. fat), Sadri (ar. i pari i fesë), Salih (tur. shq. i mirë), Selim (ar. shq. i shëndoshë, i ruajtur), Serbeze (tur. shq. e lirë), Skënder (tur. shq. mbrojtës i njerëzve), Sylë (hipoko. nga Sylejmani), Shaban (emri i muajit të tetë në numërimin islam të muajve), Shiqere (pers., shq. ëmbël), Shehrie (pers., shq. Qytet), Sherif (ar., shq. i parë, autoritativ), Tahir (ar., shq. i pastër), Zajm (tur. shq. udhëheqës), Zarife (ar. shq. e bukur), Zizë (hipoko. nga Hazize) *Smailoviq, I. (1977) MIOPBH. Sarajevë. f. 363 etj*¹³.

Konstatime përmblylëse të aspekteve socioonomastike

Nga sa u pa në aspektin socioonomastik, të gjitha antroponimet e përmendura në rend të parë kanë vlerat morale dhe se kuptimi i tyre reflekton pikënisjen dhe dëshirën e prindërve për fëmijët e tyre që ata të jenë shembuj veprash të mira. Rëndësia dhe vlera e madhe në përmbajtje e këtyre antroponimeve është e lidhur me fenomene të rëndësishme të cilat paraqesin simbolikisht ide të e larta dhe domethënëse për mbarë njerëzimin. Të gjitha kuptimet paraqesin ide të shëndosha e përparimtare që kanë shpërndarë retë e errëta të mosdijes, duke arritur kulmin e madhësisë, duke prezantuar qytetërim, fuqi, vlerë, kulturë, dinjitet etj., si faktorë të rëndësishëm të bashkësisë njerëzore. Rëndësia dhe vlera e madhe e kuptimësisë së këtyre emrave është e lidhur edhe me ndërgjegjen e pastër, manifestimin e barazisë dhe paqes dhe gatishmërinë për mbrojtje të nderit, gjuhës dhe traditës. Të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh profesionin e prindërve, pozitën dhe shtresën shoqërore që përfaqësojnë, kanë njësoj të drejtë për emërmarrje, madje as titujt dhe pozititat shoqërore nuk favorizojnë asnjërin, (*bajraktarë e udhëheqës luftarakë*), të gjithë janë të barabartë. Shumica e emrave provojnë durimin dhe qëndrueshmërinë, e kjo në këtë trevë ishte më se e domosdoshme, andaj përmes emrave të tillë edhe marrim porosi të qarta se si do të duhej të dukeshin në mendjen e banorëve emërbartësit, me theks të veçantë në dëshirën kolektive që ata të kenë virtyte të larta njerëzore. Antroponimet në një farë mase simbolizojnë domosdoshmërinë e mënjanimit nga të gjitha veset negative dhe synimin për lavdinë, famën, të vërtetën, trimërinë, guximin etj. dhe secili sish ngërthen në vete shumë data, shumë ndodhi, shumë histori. Mjafton që në tëpamje të vështrojmë kuptimin e emrave të besimit mysliman: zot, udhëheqës, i lavdëruar, dritë, gur i çmuar, luan, baba i popullit, i festuar, i jashtëzakonshëm, i shkëlqyeshëm etj., që të kuptojmë një gjithëpërfshirje përmbajtësore në të gjitha etapat e caktura kohore, që nga islamizimi e këndeje. Siç mund të shihet edhe nga shembujt e sjellë, emrat myslimanë të burimit oriental në anë të Pejës me rrethinë janë mjaft të shpeshtë madje, po të shikohen në krahasim me emra të ndonjë burimi tjetër, mund të thuhet se zënë vendin më të madh në antroponiminë e kësaj treve. Siç u shtruan edhe më lart, ata në përgjithësi shprehin cilësi të mira dhe të çmuara morale dhe

fizike, ose mbajnë emrin e ndonjë shtaze të njohur e me të cilën është menduar të mbrohej fëmija; ka edhe mjaft raste kur përmes antroponimeve të këtilla shprehet respekti ndaj besimit fetar të fesë përkatëse etj.

Vlen të theksohet se në fillet e pranimit të fesë së re e njëkohësisht edhe të emrave myslimanë të gurrës orientale, popullata, siç dëshmohet edhe në terren, nuk e dinte domethënien e antroponimeve të tilla, gjë që nuk kishte ndodhur vetëm në anën tone, sepse kjo dukuri ka qenë e përgjithësuar. Një dukuri të tillë sot e hasim pak ose fare pak. Përkitazi me këtë çështje prof. I.Smailoviq, ndër të tjera shkruan: “janë të pakët ata që ia zgjedhin emrin oriental fëmijës së vet të vetëdijshëm për domethënien e tij”. Kjo vlen edhe për anën e hulumtimit tonë. Së këndejmi, shihet nevoja e madhe që për këtë grup antroponimesh të shkruhet dhe të shpjegohet domethënia e tyre edhe në gjuhën tonë.

Referencat

- [1]. Tërnavë, M. (1979) Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI..., në OK Prishtinë. f. 112.
- [2]. Krasniqi, M. (1979) Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike, Prishtinë. f. 385.
- [3]. Shpuza, G. (1995) Islamizimi ndër shqiptarët, në KP, 1-2. f. 161.
- [4]. Shkurtaç, G. (2001) Onomastikë dhe etnolinguistikë. SHBLU, Tiranë. f. 23.
- [5]. Mujaj H. (1983) Koha 4. Titograd. faq. 443.
- [6]. Hadzic, A. (1970) O islamizaciji u sjeveroistočnoj Bosni, Prilozi za orijentalnoj filologiju, SV XVI-XVII, 1966-67, Sarajevo, f. 5.
- [7]. Smailoviq, I. (1977) MIOPBH, Sarajevë. f. 49.
- [8]. Po aty, f. 49.
- [9]. Skalic, A. (1965) Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, izd. Svjetlost, Sarajevë.
- [10]. FGJSSH. (1982). Rilindja. Prishtinë.
- [11]. Krasniqi, M. (1979) Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike, në OK, Prishtinë. f. 386.
- [12]. Elezoviqit, G. (1932) RKMD S I Beograd. f. 3.
- [13]. Smailoviq, I. (1977) MIOPBH, Sarajevë. f. 363.